



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2020:052719  
Datë: 23.11.2022  
Numri i dokumentit: 03680192

**C.nr.68/2020**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Divizioni Civil,** gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditëses KS “E.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë përfaqësuesit e autorizuar F. Sh., V. K. dhe F. H., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit E. S. K. nga fshati Optrushë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar Av. A. D. - B. nga Prishtina, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 3,315.00 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor, dhe zbatimit të provave, më **17.11.2022**, morri këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses, **SI E BAZUAR,**

**DETYROHET** i padituri **E. S. K.**, që paditëses **KS “E.”** me seli në Prishtinë, t’ia kompensoj në emër të regresimit të borxhit shumë prej **3,315.00 Euro**, me kamatë vjetore në lartësi prej 8 %, e cila do të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi 17.11.2022.

**DETYROHET** i padituri që paditëses ti paguajë edhe shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 40,00 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Paditësja KS “E.” me seli në Prishtinë kësaj gjykate i ka parashtruar padinë për rimbursimin e dëmit kundër të paditurit E. S. K. nga fshati Optrushë, Komuna e Rahovecit.

I padituri nëpërmjet përfaqësueses së tij të autorizuar kanë parashtruar përgjigje në padi me të cilën kanë deklaruar se baza juridike e padisë lidhur me shkakun e aksidentit është pjesërisht kontestuese.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar disa seanca të shqyrtimit kryesor në të cilën është paraqitur përfaqësuesit e autorizuar të paditëses F. Sh., V. K. dhe F. H., ndërsa për të paditurin përfaqësuesja e autorizuar Av. A. D.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses F. Sh. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës, duke e njoftuar gjykatën se kanë pranuar përgjigjen në padi dhe pas analizimit të të njëjtës meqenëse i padituri pjesërisht e konteston bazën juridike të kërkesëpadisë në kuptim të përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit gjykatës i propozojnë që të nxjerrë një ekspertizë të komunikacionit me të cilën do të konstatoj përgjegjësia e pjesëmarrësve në shkaktimin e këtij aksidenti. Pas pranimit gjitha deklarimeve nga seancat e kaluara, e kanë pranuar ekspertizën e

ekspertit të komunikacionit ndaj të njëjtës nuk kemi pyetje dhe vërejtje për ekspertin, pas administrimit të provave i propozoi gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës Av. A. D. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Sa i përket propozimit të palës paditëse për përpilimin e ekspertizës lidhur me rrjedhën e aksidentit e kundërshtojnë për shkak që me provat të cilat janë proceduar në këtë çështje juridike nuk janë marrë konform dispozitave të LPK-së. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe të pa mbështetur në provat me të cilat kishte për tu vërtetuar gjendja faktike si dhe baza ligjore. Për kundër faktit që paditësja pretendon për rimbursimit e dëmit, por deri me tani nuk është vërtetuar fajësia kontributi eventual gjendja faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjithashtu deri me tani me asnjë provë relevante nuk është vërtetuar fajësia e të paditurit që këtu kërkohet rimbursimi. Me provat që janë procedura në këtë çështje juridike, këto prova nuk janë marruar konform dispozitave të LPK-së, ngase paditësi si kompensues e dëmit ka bërë vetë vlerësimin e dëmit e ka kompensuar dëmin për të cilin kërkon rimbursim pa pasur fillimisht të qartë bazën ligjore lidhur me fajësinë ose kontributin e të dy pjesëmarrësve në këtë aksident. Me provat te cilat pretendon baza ligjore për rimbushim këto prova nuk vërtetojnë saktë dhe drejt gjendjen faktike as bazën ligjore pasi që këto prova nuk kanë prezantuar asnjë here këtu të paditurit, janë siguruar me procedurë administrative nga vet paditësja dhe si të tilla janë prova të njëanshme. Gjatë procedurës gjyqësore nuk është vërtetuar edhe nga kjo ekspertizë edhe nga ndonjë ekspertizë tjetër e lëmisë përkatëse meqenëse do të vërtetonte pretendimet e paditësit dhe të tilla kanë mbet si të njëanshme dhe të pa bazuara. Meqenëse ekspertiza e komunikacionit ka konstatuar se shkaktar i këtij aksidenti është automjeti A apo këtu i padituri nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë as shpejtësia as vëllimi i dëmit ndërsa llojet e tjera të lëndimeve dhe shumat e kërkuara për rimbursim në këtë çështje juridike e të cilat nuk janë vërtetuar me asnjë ekspertizë nga lëmia përkatëse por pretendohet me disa prova të cilat janë nxjerr në procedurë administrative të cilat prova janë të njëanshme dhe të njëjta gjykata nuk mund ti falë besim. Kërkojnë nga gjykata edhe shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në padi në shumë prej 104,00 euro si dhe në emër të përfaqësimit në këtë seancë dhe dy seanca të kaluara nga 135,00 euro.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata e ka zbatuar procedurën e provave duke bërë shikimin në raportin policor 2018-GR- 0975 i datës 23.12.2018, ka bërë shikimin në marrëveshjen jashtëgjyqësore nr. 95/2019 e datës 19.03.2019, e lidhur në mes të paditëses dhe avokatit J. F. B., ka bërë shikimin në transaksionin respektivisht listës së dëmeve për pagesa e datës 29.03.2019, ka bërë shikimin në marrëveshjen jashtëgjyqësore nr. 96/2019 të datës 12.02.2019, i lidhur me mes të paditëses dhe avokatit Xh. A., ka bërë shikimin në transaksionin për kompensimin e dëmit për avokatin Xh. A. e datës 07.03.2019, ka bërë shikimin në mendimin mjekësor të censorit Dr. A. P. për të dëmtuarin L. R. me nr. të referencës 96/19, ka bërë shikimin në mendimin mjekësor të censorit Dr. A. P. për të dëmtuarin A. M. me nr. të referencës 95/19, ka bërë shikimin në procesin për bartjen e veturës së aksidentuar e datës 29.12.2018 të lëshuar nga E. AG, ka bërë shikimin në procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit i datës 18.01.2019 me nr. të dëmtimit 56/19, ka bërë shikimin në procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit i datës 11.01.2019 me nr. të dëmtimit 56/19, ka bërë shikimin në transferin bankar i datës 07.08.2019, ka bërë shikimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore 56/19 e datës 24.04,2019 e lidhur në mes të paditëses dhe palës së dëmtuar A. M., ka bërë shikimin në policën e sigurimit e datës 25.10.2018, ka bërë shikimin në 7 faqe të fotografive të veturës së aksidentuar dhe palës së dëmtuar, ka bërë shikimin në raportet

mjekësore për të dëmtuarin A. M., si dhe ka bërë shikimin në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Burim Krasniqi e datës 28.10.2022.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Nga provat e zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në raportin policor 2018-GR- 0975 i datës 23.12.2018, vërtetohet se me datën 23.12.2018, ka ndodhur aksidenti i cili është shkaktuar deri sa vozitësi “A” – (E. K.), ka qenë duke e vozitur automjetin nëpër rrugën tranzite në Prizren, nga Lagja “Arbana” në drejtim të lagjes “D.” dhe kur kishte arritur në një kthesë në të djathtë (te ura) nuk e kishte përshtatur shpejtësinë me kushtet e rrugës kishte kaluar në anën e kundërt dhe gjatë frenimit automjeti ishte kthyer dhe me pjesën anësore të majtë e kishte goditur në pjesën e përparme të majtë automjetin “B” i cili ishte duke lëvizur nëpër shiritin e vet. Lëndime trupore kanë pësuar që të dy vozitësit si dhe L. A. R., i cili ishte edhe pasagjer në veturën “B”. Vozitësi “A” nuk posedonte patent shofer.

Me shikimin në marrëveshjen jashtëgjyqësore nr. 95/2019 e datës 19.03.2019, nga e cila marrëveshje vërtetohet se KS “E.”, me të dëmtuarin A. M. (Av. J. B.), për kompensimin e dëmit në shumë totale prej 577,00 €.

Me shikimin në marrëveshjen jashtëgjyqësore nr. 96/2019 e datës 12.02.2019, nga e cila marrëveshje vërtetohet se KS “E.”, me të dëmtuarin L. R. (Av. Xh. A.), për kompensimin e dëmit në shumë totale prej 559,00 €.

Me shikimin në procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit i datës 11.01.2019 me nr. të dëmtimit 56/19, nga i cili janë konstatuar pjesët e dëmtuara të veturës Citroen.

Me shikimin në transferin bankar i datës 07.08.2019, vërtetohet se janë transferuar në emër të A. M. shuma e mjeteve prej 2,179.00 €.

Me shikimin në marrëveshjen jashtëgjyqësore 56/19 e datës 24.04.2019 vërtetohet se është lidhur në mes të paditëses dhe palës së dëmtuar A. M., për shumën e mjeteve 2,179.00 €.

Me shikimin në policën e sigurimit e datës 25.10.2018, vërtetohet se A. M. ka qenë i siguruar te paditësja.

Me shikimin në 76 faqe me fotografi të veturës së aksidentuar, vërtetohet dëmi i shkaktuar.

Me shikimin në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit B. K. e datës 28.10.2022, i cili ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasoj e lëshimeve të ngasësit të automjetit “TAUREG”, i cili nuk ia ka përshtatur shpejtësinë (dhe mënyrën e lëvizjes kushteve (dhe rrethanave të krijuara në trafik, ku i njëjti gjatë drejtimit të automjetit të tij në rrugën ku rruga ishte e lagësht, kthesë (dhe tatëpjetë (teposhtë) i njëjti hynë në këtë pjesë të rrugës me shpejtësi më të madhe se shpejtësia me të cilën automjeti do të kishte përballuar kthesën në kushtet e rrugës në momentin e aksidentit, veprim ky që ia obligon edhe neni 53 dhe nenin 73 i Ligji Nr. 05/1-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, kështu që si pasoj e këtij veprimi ngasësi i automjetit

Taureg nuk arrin që të mbaj automjetin e tij nën kontroll, gjegjësisht nuk arrin që të mbaj në shiritin e tij të lëvizjes, ku pjesa e pasme e automjetit kalon në shiritin kundërt qarkullues, e me këtë rast me pjesën anësore të majtë e godet automjetin Citroen C5 i cili në atë moment ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues, në kahje të kundërt me automjetin Taureg. Pra deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve teknike të ngasësit të automjetit “Taureg”.

Lidhur me pretendimin e përfaqësueses të autorizuar të të paditurit se deri me tani nuk është vërtetuar fajësia kontributi eventuale gjendja faktike deri me tani me asnjë provë relevante si dhe nuk është vërtetuar fajësia e të paditurit që këtu kërkohet rimbursimi, gjykata nuk e mori për bazë ngase me të gjitha provat materiale është vërtetuar se shkaktar i këtij aksidenti është automjeti A respektivisht këtu i padituri në bazë të ekspertizës së komunikacionit të datës 28.10.2022 si dhe të dëmtuarit janë kompensuar për dëmin e shkaktuar.

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia me dispozitën e nenit 14 par.2 parasheh se: *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur: 1.2. drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”*.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe si bazë e dispozitave të lartcekura si dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143 dhe 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
C.nr.68/2020 më 17.11.2022**

B. Profesional  
Armond Qmega

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.